



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:028376

Datë: 23.12.2020

Numri i dokumentit: 01367880

C.nr.343/20

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi me bashkëpuntoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në çështjen kontestimore të paditëses K. M nga Gjilani, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit av. Vehbi Ismajli nga Prishtina, , ndaj të paditurës S. i P... në Gjilan, të cilën e përfaqëson me autorizim S. A nga Gjilani, me objekt kontesti, pagesa e shpërblimit jubilar, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, më datë 14.12.2020, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses K. M nga Gjilani dhe detyrohet e paditura S. i P... në Gjilan, që paditëses t'ia paguaj tri (3) paga jubilarë mujore në shumë të përgjithshme prej 1,413.24 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga dita e pranimit-dorëzimit të këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej 260.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Paditësja K. M nga Gjilani, përmes të autorizuarit të saj në këtë gjykatë më datë 19.02.2020, ka paraqitur padi kundër të paditurës S. i P... në Gjilan. Në përmbajtjen e padisë ka theksuar se paditësja është punëtore e S. i P... në Gjilan, në detyrat e punës kryeinferimiere e reparitit të ortopedisë ku edhe i realizon të ardhurat personale, andaj gjykatës i ka propozuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses dhe detyrohet e paditura S. i P... në Gjilan, që paditëses t'ia paguajë tri (3) paga jubilarë mujore në shumë të tërësishme prej 1,413.24 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Përfaqësuesi i paditëses në shqyrtimin kryesor ashtu edhe në spjegimet përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së paditëses si dhe provave të ofruara, duke i propozuar gjykatës që si provë të administrojë kontratën e punës në kohë të pacaktuar me nr. 1995 e dt. 31.12.2012, vërtetimi i marrëdhënies së punës nr. ... e dt. 20.11.2019, Pasqyrën bankare e dt.21.11.2011 nga NLB Banka dhe lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i RKS në emër të paditëses, më tutje ka theksuar se paditësja bazën juridike e mbështet në neni 17, paragrafi 3 pika 3.3 e Kontratës Kolekive Sektoriale në Shëndetësi, e cila është në fuqi nga data 18.06.2018 dhe në fund ka kërkuar nga Gjykata që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj në tërësi si të bazuar në ligj. Gjithëashtu i njëjti i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës duke i specifikuar edhe atë: për përpilimin e padisë shumë prej 104 €, për një seancë gjyqësore shumë prej 135.20 € si dhe në emër të taksës gjyqësore shumë prej 21 €, të gjitha në shumë prej 260.20€.

I autorizuari i të paditurës në shqyrtimin kryesor ashtu edhe në spjegimet përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, duke theksuar se është e vërtetë se paditësja në SPGJ, ka filluar punën me datë 01.12.1988 dhe ka përvojë pune mbi 32 vite çka nuk është kontestuese, mirëpo vlera e kërkuar prej 1,413.24 €, është kontestuese pasi që janë llogaritur të gjitha nga përvoja e punës, kujdestaritë dhe shtesat e tjera, e që realisht paga duhej të llogaritej në vlerë prej 1.131 €, duke pas parasysh pagën mujore, po ashtu ka cekur se si organizatë publike kanë buxhet të ndarë prej 820.000 €, ku janë të përfshira të gjitha kategoritë e shpenzimeve, mirëpo M. e Sh që e ka lidhur kontratën me F. e S, e cila i obligon institucionet shëndetësore që ta zbatojnë një marrëveshje të tillë me rastin e aprovimit të buxhetit nuk kanë ndarë mjete buxhetore për këtë kategori.

Gjykata për të vepruar drejtë dhe për t'i vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse si dhe për ta vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore ka administruar dhe vlerësuar këto prova materiale: Kontratën e punës me nr... e dt. 31.12.2012; Vërtetimi i marrëdhënies së punës nr. ... e dt. 20.11.2019; Pasqyra bankare e datës 21.11.2011 nga NLB Banka; Lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i RKS në emër të paditëses.

Gjykata pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK -së dhe në bazë të rezultatit të gjithmbarshëm të procedurës kontestimore, vërtetoi këtë gjendje faktike: Se paditësja është në marrëdhënie pune në S. i P... në Gjilan, në vendin e punës Infermiere – tani kryeinfermiere, në R. e O... që nga data 01.12.1988, fakt këto që vërteton nga Kontrata e punës me nr. ... dt. 31.12.2012 si dhe vërtetimi i marrëdhënies së punës nr. ... e dt. 20.11.2019.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësja ka filluar punën në pozitën e infermieres në S. i P... në Gjilan, para 32 viteve, po ashtu nuk është kontestuese se e nja ka një përvojë pune mbi 32 vite, nuk është kontestuese as baza ligjore, por për të paditurën

kontestuse është se e njëjta nuk ka mjete financiare për të paguar shpërblimin jubilar të paditëses.

Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditëses, bazës juridike të padisë dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratë Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, konkretisht nenin 3 paragrafi 3 pika 3.3 e cila ka hyrë në fuqi nga dt.11.06.2018, në të cilën dispozitë është përcaktuar *“Punëtorët shëndetësor, për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. Punëdhënësi i fundit është që paguan shpërblimin jubilar. Shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf, andaj vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.*

Kamata ligjore prej 8% në vit është përcaktuar konform nenit 382 të LMD, në të cilën dispozitë shprehimisht është përcaktuar se *„Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”* kurse lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi që ta detyrojë të paditurën që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore edhe atë: për përpilimin e padisë shumë prej 104 €, për një seancë gjyqësore shumë prej 135.20 € si dhe në emër të taksës gjyqësore shumë prej 21€, të gjitha në shumë prej 260.00€, duke u bazuar në nenin 452.2 të LPK-së.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 143 të LPK-ës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr. 343/20, me datë14.12.2020

Gjyqtarja
Floriqe Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të vendimit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.